



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit		
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	e	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	e	
	Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI-të		
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	i	Datë: 15.07.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	e	Nr.020-378/9
	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë		
	2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse		
Lënda:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave		
	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave		
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit		
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës		

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin Nr. 12-020/04-28733** për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Glllogocit, i plotësuar, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretar/Office of the General Secretary

REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Tim Berisha, u.d. i sekretarit të përgjithshëm në MPL
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Fadile Dyla, zv. sekretare e përgjithshme/MASHPI
NGA/OD/FROM:	Nazmije Maxhuni-Kastrati, zyrtare e lartë ligjore/MASHPI Elhame Shabani, zyrtare e lartë ligjore/MASHPI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gillogocit me nr. 020-3 8/8 e dt. 05.07.2021

Të nderuar,

Lidhur me kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Gillogocit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Gillogocit, opinioni ynë është si në vijim:

Në bazë të nenit 6 të Udhëzimit administrativ me nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, përfaqësuesit e emëruar me vendim nr. 12-020104-28733 dt. 29.06.2021 nga Kuvendi komunal i Gillogocit janë në përputhje me UA.

Me respekt!



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenas(Glllogoc)
Kuvendi i Komunës**



Nr. 12-022/04-28733, dt. 29.06.2021

Bazuar në nenin 11, 12, paragrafi 1 dhe 40, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor, si dhe rekomandimit të DKA-së në Drenas, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë **29.06.2021**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, **i plotësuar**

Neni 1

Më këtë Vendim caktohen anëtarët e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, si vijon:

1. Arbësa Islami Dobra – Ma.sc. Pedagogji (DKA);
2. Arben Haziri – Ma.sc. Gjuhë Shqipe (Këshilli i Prindërve);
3. _____ - Anëtar nga MASH TI.

Neni 2

Ky komision ka për detyrë që procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve t'i zhvillojë në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të komisionit nga DKA për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucione Arsimore është për një (1) vit shkollor.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatesë;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj